

### **Vendim nr. 371, datë 30.05.2023 (i shkurtuar)**

Bazuar në nenin 5 paragrafi 1.1 të ligjit nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike” dhe nenit 7, paragrafi 1 gërmat “c”, “e”, “f” dhe paragrafit 3 të Udhëzuesit “Për rregulla dhe procedura të verifikimit të rrethanave dhe fakteve mbi dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit” miratuar me Vendimin e Autoritetit nr. 625/10, datë 30.03.2023, Autoriteti

#### **V E N D O S I:**

1. Miratimin e fillimit të procedurës së verifikimit administrativ për qartësimin e rrethanave dhe fakteve, për rastet e propozuara me objekt:
  - (1) verifikimi për qëllime të qartësimit të fatit, identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të të zhdukurve dh të ekzekutuarve në lidhje me personat që kanë humbur jetën në burgun e Spaçit (Mirditë);
  - (2) verifikimi për qëllime të qartësimit të fatit, identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të të zhdukurve dh të ekzekutuarve në lidhje me praktikën mbi shtetasin T.S;
  - (3) verifikimi për qëllime të qartësimit të fatit, identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të të zhdukurve dh të ekzekutuarve në lidhje me praktikën mbi shtetasin Sh.K;
  - (4) verifikimi për qëllime të qartësimit të fatit, identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të të zhdukurve dh të ekzekutuarve në lidhje me praktikën mbi shtetasin E.A.
  - (5) verifikimi për qëllime të qartësimit të fatit, identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të të zhdukurve dh të ekzekutuarve në lidhje me praktikën mbi shtetasin G.H.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Dr. Gentiana Sula

**Anëtarë:** Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha, Gjergj Marku, Skënder Vrioni